



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 16, Datë 26.02.2016**

**PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE DHE SHTESAVE NË  
RREGULLOREN NR. 32, DATË 28.05.2015 “PËR ORGANIZIMIN DHE  
FUNKSIONIMIN E QENDRËS SË EDUKIMIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, të nenit 244, të ligjit nr. 52/2014, datë 22.5.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Qendrës së Edukimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I :**

- 1. Miratimin e disa ndryshimeve dhe shtesave në rregulloren nr. 32, datë 28.05.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Edukimit”, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet Qendra e Edukimit për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Enkeleda SHEHI**

**Ndryshimet dhe shtesat në Rregulloren nr. 32, datë 28.05.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Edukimit”**

**1. Neni 5, paragrafin II, ndryshon si më poshtë:**

*“Qendra lëshon certifikata për kualifikim profesional pas kalimit me sukses të aktiviteteve të zhvilluara prej saj, dhe certifikata pjesëmarrjeje për trajnime të edukimit në vazhdim sipas modelit në aneksin 1 bashkëngjitur kësaj rregullore”.*

**2. Në neni 5, shtohet paragrafi III, si më poshtë:**

*“Për aktivitetet e zhvilluara nga Qendra, në bashkëpunim me institucione apo shoqata të ndryshme vendase apo të huaja, në certifikatat e lëshuara prej saj, do të pasqyrohet logo së bashku me firmën e përfaqësuesit të këtij institucioni”.*

**3. Në neni 9, paragrafi I, pika 2, fjalia e parë, ndryshon si më poshtë:**

*“Edukimi në vazhdim. Në përfundim të trajnimit kandidati pajiset me certifikatë pjesëmarrjeje”.*